

923 13.9.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3416

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 12.09.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.93

Datë: 07.09.2023

“Miratimi i nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe Institucioneve të varësisë për vitin
2023”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Adresa: | Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel: 0035521822935

[Handwritten signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 93 Datë 07 / 09 /2023

“Miratimi i nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2023”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në VKM nr.165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore”, për efekt page dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr.625 datë 28.09.2022, në VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve të tjerë të institucioneve buxhetor dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar me VKM nr.234 datë 20.04.2022, si dhe me vendimin nr.328 datë 31.05.2023, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 07.09.2023, me 17 vota pro, 5 kundër dhe 0 apstenim;

VENSOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe institucioneve në varësi të saj, bazuar në VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore”, për efekt page dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore, i ndryshuar me VKM nr.625 datë 28.09.2022, në VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të institucioneve buxhetore dhe nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar me VKM nr.234 datë 20.04.2022, i ndryshuar me VKM nr.328 datë 31.05.2023: sipas tabelave bashkëlidhur tabelave:

2. Këshilltarët të shpërblëhen në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë Dibër, ndërsa kryetarët e fshatrave në masën:

- 4.4% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë} (0-300) banorë
- 6% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë} (301-600) banorë
- 7% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë} (601-1000) banorë
- 9% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë} (+1000) banorë
- 6% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë} (0-300) banorë

- 8% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë} (301-600) banorë
- 9% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë} (601-1000) banorë
- 10% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë} (+1000) banorë


3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Personelit) dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.

4. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore të Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.

5. Vendimi u shpall me datë **07.09.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Iriini Shehu





3616/14/09/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.923/1.prot.

Peshkopi, më 13.09.2023

Lënda : Per vendimin nr. 93, datë 07.09.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër

BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.93, datë 07.09.2023 "Per miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe institucioneve të varësisë për vitin 2023", vendosa :

Miratimin në parim të aktit administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e pagave , që duhet të shkojnë në harmoni me buxhetin e miratuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara së fundi nga qeveria për rritjen e pages minimale dhe pages për nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ, veprime që kurdoherë janë përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që kanë paraqitur për miratim projekt aktin dhe relacionin shpjegues mbi bazën e të cilit ka dalë vendimi i ardhur pranë nesh për verifikim ligjshmërie.

Kujtojmë se rritja e nivelit të pagave për punonjësit administrative dhe nëpunësve civil është detyrim ligjor që buron veç të tjerash nga VKM nr.328, datë 31.05.2023. mos respektimi i të cilit ngarkon me përgjegjësi direkte strukturën përgjegjëse e cila është subjekt kontrolli nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

P R E F E K T I
Nexhbedin SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBER
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PROJEKT-VENDIM

Nr. 20 Datë 01/04/2023

MIRATIMI I NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË DIBËR DHE
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2023.

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, " Për vetëqeverisjen vendore " ,në VKM nr. 165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar me VKM nr.625 datë 28.09.2022, në VKM nr.717 datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve te tjere të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar me VKM nr. 234 datë 20.04.2022, si dhe me vendimin nr.328,date 31.05.2023:

KËRKOJMË:

1. Miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe institucioneve në varësi të saj, bazuar në VKM nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar me VKM nr.625 datë 28.09.2022, në VKM nr.717 datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve te tjere të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar me VKM nr. 234 datë 20.04. 2022, i ndryshuar me VKM nr.328,date 31.05.2023: sipas tabelave bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Këshilltaret të shpërblehen në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë Dibër, ndërsa kryetarët e fshatrave të shpërblehen në masën:
 - 4.4% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (0-300) banorë
 - 6% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (301-600) banorë
 - 7% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (601-1000) banorë
 - 9% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (+1000) banorë
 - 6% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (0-300) banorë

- 8% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (301-600) banorë
- 9% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (601-1000) banorë
- 10% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (+1000) banorë

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Personelit) dhe Drejtoria Ekonomikë (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Dibër .

PËR BASHKINË DIBËR :

Përgjegjës i Burimeve Njerzore

Malbora Lala



Drejtori Ekonomik

Mensur Shehi



Drejtori Juridik

Ismet Saraçi



KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

